




Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly



PËR / ZA / TO	z. Pal Lekaj, Ministër i Infrastrukturës	DATE DATUM DATE	06.06.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së <i>Avdullah Hoti</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:**

Rruga "Tirana" në gjatësi prej 300 metra, është rrugë në Mitrovicën Veriore e banuar kryesisht nga shqiptarët, e cila është e dëmtuar dhe ka nevojë për t'u asfaltuar.

Ky projekt nuk kërkon shumë të madhe për realizimin e saj. Në amendamentin e bërë nga Grupi Parlamentar i LDK-së, ky projekt është përfshirë në buxhetin e vitit 2018 me titull "Asfaltimi i rruges Tirana, ne Mitrovicen Veriore" me (kodi i projektit 15763).

Përfaqësuesit e kësaj lagje kanë shprehur vullnetin që të ndihmojnë në realizimin e këtij projekti, në rast të ndonjë çështjeje pronësore apo adaptim të projektit.

**PYETJA:**

**Në çfarë faze është projekti tani?**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

KUVENDI I KOSOVËS  
ASSEMBLY OF KOSOVO  
Propozim për Ligj: Propozimi për Ligjin për...  
06/1464/90-825  
06.06.2018

PËR / ZA / TO	z. Skënder Reçica, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale	DATE DATUM DATE	06.06.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

**Çështja:**


Ndërtimi i kulmeve në tri (3) shtëpi në Kodrën e Minatorëve në Mitrovicë është nevojë imediate e tri familjeve, gjendja ekonomike e të cilave është shumë e vështirë dhe këto familje nuk mund të marrin asnjë ndihmë tjetër. Ndihamat që marrin ato, nuk ju mjaftojnë për nevojat elementare. Kostoja për ndërtimin e këtyre tri kulmeve është simbolike.

Me propozim të Grupit Parlamentar të LDK-së, ky projekt është përfshirë në buxhetin e vitit 2018 me titull "Ndërtimi i kulmeve në 3 shtëpi në Kodrën e Minatorëve në Mitrovicë" (kodri i projektit 15790), në kuadër të investimeve kapitale të MPMS-së.

**PYETJA: Ku ka arritur ky projekt deri më tani?**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**



PËR / ZA / TO	z. Skender Reçica, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale	DATE DATUM DATE	06.06.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

**Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**


**Çështja:**

Ndërtimi i 10 shtëpive në Lagjen Kroi i Vitakut është kërkesë e vazhdueshme e banorëve të asaj lagje. Janë gjithsej 75 shtëpi të djegura në këtë lagje që kanë mbetur të pa ndërtuara. Shumë nga këta banorë janë të zhvendosur nëpër lagje të tjera të Mitrovicës, duke paguar qira tash e sa vite apo duke jetuar tek të afërmit e tyre. Ndërtimi i tyre do të mundësonte kthimin e këtyre familjeve në trojet dhe në lagjen e tyre.

Me propozim të Grupit Parlamentar i LDK-së, ky projekt është përfshirë në buxhetin e vitit 2018. Titulli i projektit është “Ndërtimi i 10 shtëpive për çdo vit në Lagjen Kroi i Vitakut” (me kod 15791).

**PYETJA:**

**Ku ka arritur ky projekt deri më tani?**



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

<b>PËR / ZA / TO</b>	z. Skender Reçica, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale	<b>DATE</b> <b>DATUM</b> <b>DATE</b>	06.06.2018
		<b>Reference</b>	
<b>NGA / OD / FROM</b>	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
<b>SUBJEKTI</b> <b>PREDMET</b> <b>SUBJECT</b>	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

**Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja:**

Dy shtëpi në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë janë të dëmtuara dhe rrjedhimisht edhe të pabanueshme. Njëra shtëpi (Afrim Koshi) është e plasaritur në masë të madhe dhe rrezikohet nga rrënimi. Në këtë shtëpi aktualisht banojnë 5 anëtar, 3 prej tyre fëmijë. Po ashtu, edhe shtëpia e dytë (Muhamet Tahiri) është e shkatërruar dhe e pabanueshme.

Me propozim të Grupit Parlamentar i LDK-së, në buxhetin e vitit 2018 është futur projekti me titull "Ndërtimi i dy shtëpive në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë", me kod (15792).

**PYETJA:**

**Ku ka arritur ky projekt deri më tani?**



REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI I REPUBLIKES SE KOSOVES  
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO  
Prishtine  
Propozime dhe Propozime-Korrigjime te Propozimeve  
No. Prof. 06/1467/10-928  
Data 06.06.2018  
PRISHTINE

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

PËR / ZA / TO	z. Shyqiri Bytyqi, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	DATE DATUM DATE	06.06.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

**Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja:**

Fasadimi i Shkollës Fillore "Aziz Sylejmani" në Mitrovicë është kërkesë e vazhdueshme e prindërve, nxënësve dhe e mësimitdhënësve të kësaj shkolle. Lënia e kësaj shkolle pa fasadim paraqet rrezik për fëmijët dhe stafin mësimitdhënës të kësaj shkolle, duke qenë se fasada e vjetër është e paqëndrueshme dhe e dëmshme.

Me propozim të Grupit Parlamentar të LDK-së, në buxhetin e vitit 2018 është përfshirë projekt i ri "Fasadimi i Shkollës Fillore 'Aziz Sylejmani' në Mitrovicë" (kodi i projektit 15782).

**PYETJA:**

**Ku ka arritur ky projekt deri më tani?**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
SKUPŠTINA REPUBLIKE SË KOSOVËS  
ASSEMBLY OF THE REPUBLIC OF KOSOVO  
Drutë, Prishtinë dhe në Komunat dhe Komunën e Prishtinës dhe Prishtinës së Re  
No. Protokolli i Pyetjeve  
06/1468/10-829  
Data  
06.06.2018  
PRISHTINË

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

PËR / ZA / TO	z. Shyqiri Bytyqi, Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	DATE DATUM DATE Reference	06.06.2018
NGA / OD / FROM	Avdullah Hoti Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje parlamentare për përgjigje me shkrim		

**Në bazë të Nenit 46 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.**

**Çështja:**

Ndërtimi i shkollës në Lagjen e Boshnjakëve është kërkesë e vazhdueshme e banorëve të kësaj lagje duke qenë se fëmijët e familjeve shqiptare dhe atyre të komunitetit boshnjak janë të detyruar të vijojnë mësimin në shkolla të Mitrovicës së Jugut, të cilat edhe ashtu janë të mbingarkuara. Lëvizja e fëmijëve në shkolla larg vendbanimit është e kushtueshme për familjet dhe e mundimshme për nxënësit. Një shkollë e re do të ofronte kushte më të mira për fëmijë dhe për integrim të tyre më të mirë në komunitet.

Me propozim të Grupit Parlamentar të LDK-së, në buxhetin e vitit 2018 është përfshirë projekti i ri “Ndërtimi i shkollës fillore në Lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë” (me kod 15783).

**PYETJA:**

**Ku ka arritur ky projekt deri më tani?**